



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:222351  
Datë: 19.09.2024  
Numri i dokumentit: 06181716

**C.nr.3701/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil**, gjyqtari Baki Shigjeqi, me praktikanten A.Ç. duke vendosur në çështjen juridiko - kontestimore të paditëses I.D. me numër personal ..... me vendbanim në fshati Billushë, Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson avokat D.M. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “SIGKOS”, me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit material, vlera e kontestit tremijë e njëqind euro (3,100.00 €), jashtë seance me datë 19.09.2024, mori dhe përpiloi me shkrim këtë:

**A K T G J Y K I M**

**-Në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia-**

**I. REFUZOHET E PABAZUAR** në tërësi kërkesëpadia e paditëses I.D. nga fshati Billushë, Komuna e Prizrenit, me të cilën ka kërkuar që të ***I. APROVOHET*** kërkesëpadia e paditësit I.D. nga fshati Billushë, Komuna Prizren, në tërësi si e bazuar, ashtu që ***II. OBLIGOHET*** e paditura Kompania e Sigurimeve “Siguria”, me seli në Prishtinë, që të emër të dëmtimit jomaterial-lëndimeve trupore paditëses t’ia kompensoj shumat si në vijime:, për dhimbje fizike në shumën prej 1,500.00 euro, për frikën përjetuar në shumën prej 1,000.00 euro, për dëmin material, për ndihmën dhe kujdesen e personit të tretë në shumën prej 200.00 euro, për ushqimin e përforcuar në shumën prej 200.00 euro, dhe në emër të rehabilitimit fiziko-terapeutik në shumën prej 200.00 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 %, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën përfundimtare nën kërcënimin të ekzekutimit të dhunshëm me përmbarim. ***III. OBLIGOHET*** e paditura Kompania e Sigurimeve “SIGKOS”, me seli në Prishtinë që paditëses t’ia paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në afat prej 15 ditësh prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm me përmbarim”.

**A r s y e t i m**

Paditësja I.D. nga fshati Billushë, Komuna e Prizrenit, përmes të autorizuarit të saj, avokat D.M. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 27.10.2022, ka paraqitur padi, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “SIGKOS”, me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, vlera e kontestit si në petitum të padisë, në shumën prej 3,100.00 euro.

I autorizuari i paditëses në padi ka theksuar se me datën 14.10.2022, ka ndodhur aksident i komunikacionit, ku deri te aksidenti ka ndodhur si pasojë e lëshimeve të vozitësit të automjetit A, i cili nuk respekton rregullat e komunikacionit dhe shkakton aksident me dëme materiale në automjetin B, të tipit “VW GOLF”, me targa të regjistrimit ..... ngjyrë hiri, viti i prodhimit 1999. Automjeti “A”, si shkaktar i aksidentit në momentin e shkaktimit të aksidentit ka pasur të kontraktuar policën e sigurimeve, andaj përgjegjësia për kompensimin e dëmit bie mbi Kompaninë e Sigurimeve “Sigkos”, ndërsa si rezultat i aksidentit ushtruesi i kërkesës, ka pësuar lëndime trupore, ku pas lëndimeve trupore që ka pësuar në aksident është dërguar në Klinikën Emergjente në Prishtinë, andaj meqë baza juridikë e aksidentit nuk është kontestuesi i i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave të bie aktgjykim me të cilin aprovohet kërkesëpapia e paditëses.

I autorizuari i paditëses, av. D.M. me parashtrësën e datës 16.09.2024, e ka njoftuar gjykatën se me të paditurën, kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore për kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksidentin e datës 14.10.2022, andaj edhe në mungesë të interesit juridik të procedimit të kësaj çështje, heqin dorë nga kërkesëpapia.

Gjykata, pas heqjes dorë nga kërkesëpapia nga ana e paditëses I.D. nga fshati Billushë, Komuna e Prizrenit, e cila në këtë çështje kontestimore përfaqësohet përmes avokatit D.M. nga Prizreni, konstatoi se kërkesa e kontestit është e disponueshme për palët, prandaj, në kuptim të nenit 149, paragrafit 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK-së) – me të cilin përcaktohet se *“në qoftë se paditësi deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes heqë dorë nga një pjesë e kërkesëpadisë apo nga e gjithë kërkesëpapia, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi (aktgjykimi në bazë të heqjes dorë)”* – pa shqyrtim të mëtejshëm vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
**2022:222351, 19.09.2024**

**G j y q t a r i,**

---

**Baki Shigjeqi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën. Në kuptim të nenit 181, paragrafit 2 të LPK-së, ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore apo nga shkak se heqja dorë nga kërkesëpapia është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.